

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt. 16.01.2023	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-22/A



**UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN**  
**UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN**

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000  
 Prizren, Republika e Kosovës

# **UDHËZUES PËR HARTIMIN DHE RISHIKIMIN E SYLLABUSIT**

Prizren, 2022



---

**Udhëzues për hartimin dhe rishikimin e syllabusit për mësimdhënësit dhe personelin që e mbikqyr zhvillimin e kurrikulës në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren.**



## **PËRMBAJTJA**

<b>1. HYRJE.....</b>	<b>4</b>
<b>2. PËRMBAJTJA E SYLLABUSIT.....</b>	<b>5</b>
2.1. Përshkrimi i lëndës.....	6
2.2. Qëllimet e lëndës.....	6
2.3. Rezultatet e të nxënit.....	6
2.3.1. Përdorimi i taksonomisë së Bloom-it për të shkruar rezultatet e nxënies.....	7
2.4. Ngarkesa e studentit.....	8
2.5. Metodologjia e mësimdhënies.....	8
2.6. Metodologjia e vlerësimit.....	9
2.7. Literatura (literatura primare/literatura e shtesë).....	9
2.8. Plani i mësimi dhe përmbajta e lëndës (15 javë për semestër).....	9
2.9. Politikat akademike dhe kodi i sjelljes.....	9
<b>3. RISHIKIMIT I SYLLABUSIT.....</b>	<b>10</b>
3.1. Procedura e rishikimit.....	10
<b>4. SHTOJCA I SHABLLONI I SYLLABUSIT.....</b>	<b>12</b>



## 1. HYRJE

Udhëzuesi për Hartimin dhe Rishikimin e Syllabusit në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren (UUHP), është hartuar për të mbështetur stafin akademik të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, dhe për të hartuar dhe rishikuar një syllabus për lëndët përkatëse. Udhëzuesi përcakton dhe shpjegon elementet për hartimin dhe procedurën e rishikimit të një syllabusi me qëllim që mësimitdhënësi të reflektojë në mënyrë adekuate për të hartuar një syllabus më të mirë, si një mjet i rëndësishëm për menaxhimin dhe më efektiv të një lënde. Hartimi i një syllabusi cilësor do të ndihmojë studentëve që të kuptojnë qartë pritjet e mësimitdhënësit dhe mënyrën se si do të zhvillohet lënda. Për t’u siguruar që çdo syllabus të arrijë qëllimin e synuar, si pjesë e një formati të standardizuar, syllabusi do të përfshijë këto informacione kryesore: Përshkrimin dhe qëllimin e lëndës, rezultatet e të nxënit, ngarkesën e studentit, metodologjinë e mësimitdhënies, metodologjinë e vlerësimit, materialet mësimore (literatura), përmbajtja e lëndës. Syllabusi është një dokument thelbësor dhe ndërveprimi i parë ndërmjet mësimitdhënësit dhe studentit në fillim të semestrit dhe një syllabus i hartuar mirë dhe atraktiv, dhe duke luajtur një rol të rëndësishëm në inkurajimin dhe motivimin e studentit për t’u angazhuar dhe për të marr përgjegjësi individuale dhe për t’u angazhuar me mësimitdhënësin. Prandaj, një plan-program i hartuar mirë do të shërbejë si një instrument që mësimitdhënësit dhe studentët të fillojnë një semestër të suksesshëm.



## 2. PËRMBAJTJA E SYLLABUSIT

Syllabusi është një dokument i cili përmban informacione të rëndësishme për lëndën. Prandaj, mësimdhënësi duhet të kujdeset që gjatë hartimit dhe rishikimit të syllabusit të përfshihen të gjitha elementet e kërkuara dhe informacione të mjaftueshme për realizmin e plan-programit, të kuptueshëm për studentët.

### **Formati i Syllabusit në Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, përfshinë elementet si në vijim:**

- Informacionet bazike për lëndën, duke përfshirë kështu: Nësia akademike, titulli i lëndës, programi, niveli i studimeve (baçelor apo master), statusi i lëndës (obligative apo zgjedhore), viti i studimeve, numri i orëve javore (për ligjërata dhe ushtrime), vlera në kredi – ECTS, koha e mbajtjes së mësimit/lokacioni, mësimdhënësi i lëndës, të dhënat kontaktuese (e-maili i mësimdhënësit);
- Përshkrimin e lëndës;
- Qëllimet e lëndës;
- Rezultatet e të nxënit;
- Ngarkesa e studentit;
- Metodologjia e mësimdhënies;
- Metodologjia e vlerësimit;
- Literatura (literatura bazë/literatura shtesë);
- Plan i mësimit dhe përmbajtja e lëndës (15 javë për semestër);
- Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes.



### **2.1. Përshkrimi i lëndës**

Përshkrimi i lëndës shërben si një përmbledhje bazë për të përshkruar arsyetimin e lëndës dhe një pasqyrë të përmbajtjes së temave kryesore që do të përfshihen në syllabus, të aftësive dhe njohurive të cilat do të përfitojnë studentët. Përshkrimi duhet të jetë i shkurtër (150- 200 fjalë) dhe i qartë për studentët.

### **2.2. Qëllimet e lëndës**

Qëllimi i përshkrimit të lëndës duhet të jetë në përputhje me objektivat e përgjithshme të programit të studimeve dhe nivelit të studimeve. Qëllimet duhet të paraqesin qartë pritshmërinë e të mësuarit të cilat ndodhin si rezultat i përfundimit të lëndës.

### **2.3. Rezultatet e nxënies**

Rezultatet e nxënies tregojnë atë se çka pritet të përfitojë studenti nga një lëndë dhe një përshkrim të hollësishëm për atë që do të jetë në gjendje të bëjë pas përfundimit të procesit të nxënies. Në saktësimin e rezultateve trajtohen detyra specifike, metodologjia, teknika, e kështu me radhë, në një nivel pritshmërie të kënaqshme për përmbajtjen e lëndës. Ato duhet të jenë të formuluar qartë, koncize dhe të sakta. Rezultatet e nxënies duhet të përmbajnë folje veprore, të jenë të matshme dhe të ndërlidhura me format e vlerësimit brenda lëndës. Për rezultatet e të nxënies rekomandohet të ndiqet "Taksonomia e Bloom-it"<sup>1</sup>.

Përdorimi i Taksonomisë së Bloom-it ju lejon të lidhni rezultatet tuaja me detyrat të cilat pritni që studenti të demostrojë. Gjithashtu, mund të veprojnë si udhëzues për nivelin e mësimnxënies që dëshironi të arrijë studenti juaj.

---

<sup>1</sup> Për më shumë, shih: Jessica Shabatura, "Using Bloom's Taxonomy to Write Effective Learning Outcomes", University of Arkansas, 2022 (<https://tips.uark.edu/using-blooms-taxonomy/>); "A spotlight on... Learning Outcomes with Bloom's Verb Guide", University of Liverpool, Centre for Innovation in Education 2019 (<https://www.liverpool.ac.uk/media/livacuk/centre-for-innovation-in-education/staff-guides/learning-outcomes-with-blooms-verb-guide/learning-outcomes-with-blooms-verb-guide.pdf>).



### 2.3.1. Përdorimi i Taksonomisë së Bloom-it për të shkruar rezultatet e nxënies

Domeni i njohjes përbëhet nga gjashtë nivele ku mund të përdoren për të strukturuar rezultatet e të nxënit, mësimet dhe vlerësimet e lëndës tuaj:

Nivelet sipas Bloom-it	Foljet kryesore (fjalë kyçe)
<b>Krijimi</b>	projekto, formulo, kombino, ndërto, shpikë, krijo, kompoz, propoz, gjenero, integro, modifiko, zhvillo.
<b>Vlerësimi</b>	zgjedh, mbështet, përcakto, gjyko, vlerëso, krahaso, argumento, justifikon, mbështet, bind, përzgjidh, vlerëson.
<b>Analiza</b>	klasifiko, zbërthe, kategorizo, analizo, lustr, kritiko, thjeshtëso,
<b>Aplikimi</b>	llogarit, parashiko, zbato, zgjidh, ilustr, përdor, demonstr, përcakto, modelo, krye, paraqit.
<b>Kuptimi</b>	Përkufizo, përshkruaj, shpjegon, parafrazo, rithekso, jep shembuj origjinalë, përmblihdh, interpreto, diskuto.
<b>Njohja</b>	defino, përshkruaj, skico, përcakto, emëro, cito, përsërit, identifiko, etiketo, ndërlihdh, deklaro.

## 2.4. Ngarkesa e studentit



Ngarkesa e studentit përbën numrin e orëve të nevojshme, për t'u dhënë studentëve aktivitetet mësimore me të cilat synohet të arrihen objektivat e të nxënit në një lëndë. Ajo përfshin aktivitetet e planifikuara dhe kohën e studimit jashtë klasës mësimore (kontributi në ligjërata, puna praktike, projektet, seminarët, konsultimet me mësimdhënësin, përgatitja për provime, etj.). Ngarkesa e studentit bëhet sipas llogaritjes së kredive në ECTS<sup>2</sup>. Në UUHP, ngarkesa e studentit për një kredi ECTS është e barabartë me 25 orë të llogaritura në punën e studentit (1 ECTS= 25h).

Kështu, për *shembull*: një lëndë me 6 ECTS është e barabartë 150 orë ngarkesë (6 ECTS= 150h).

Për të siguruar që studentët kanë kohë të mjaftueshme për të nxënit, është e rëndësishme të renditen të gjitha aktivitetet e përfshira në syllabus. Në llogaritjen e kredive duhet të merren parasysh edhe aktivitetet e tjera jashtë klasës mësimore (siç përmenden më lartë).

## 2.5. Metodologjia e mësimdhënies

Metodologjia e mësimdhënies përfshin mënyrat të cilat përdoren nga mësimdhënësi duke zbatuar teknika dhe aktivitete të ndryshme për të arritur qëllimet e të nxënit të lëndës. Ka metodologji të ndryshme të cilat mund të përdoren nga mësimdhënësi dhe të cilat shpesh mund të varen nga fusha e studimit, lënda, tema, etj. Gjithashtu, metoda dhe teknika të ndryshme mund të përdoren brenda një ligjërata të vetme, ose disa ligjëratave. Nga mësimdhënësi kërkohet që të saktësohen cilat metodat të mësimdhënies/nxënies do të aplikohen dhe mos të përdoren formësimet të përgjithësuara. Një numër i caktuar i metodave/aktiviteteve të cilat mund të përdoren, janë: rastet studimore, puna në grupe të vogla, ligjëratat, ushtrimet, prezentimet e studentëve, puna në grupe, esetë, punimet hulumtuese, luajtja e roleve, prezentimi i posterëve, vizitat në terren, etj. Përdorimi i metodave dhe përzërja e teknikave të ndryshme duhet të shërbejë me qëllim që studenti të nxit kureshtjen, të zhvillojë të menduarit kritik dhe shkathtësi për zgjidhjen e problemeve.

---

<sup>2</sup>Udhëzuesin e Zonës Evropian për Arsimin e Lartë (ECTS Users' Guide 2015), ([http://www.ehea.info/media.ehea.info/file/ECTS\\_Guide/77/4/ects-guide\\_en\\_595774.pdf](http://www.ehea.info/media.ehea.info/file/ECTS_Guide/77/4/ects-guide_en_595774.pdf)).





## **2.6. Metodologjia e vlerësimit**

Vlerësimi është një proces përmes të cilit formohet baza për gjykimin e arritjeve të studentëve për lëndën. Vlerësimi i studentëve duhet të aplikohet në mënyrë të vazhdueshme (jo vetëm provimi final) duke përfshirë një sërë formash të vlerësimit, me qëllim të inkurajimit të studentëve të marrin pjesë në mënyrë aktive gjatë tërë periudhës së realizimit të plan-programit të lëndës. Nota përfundimtare duhet të jetë shuma e rezultateve të studentit të arritura në kuadër të aktiviteteve të parapara për arritjen e rezultateve të të nxënit, si: pjesëmarrja, detyrat e shtëpisë, puna hulumtuese, provimi ndërmjetëm, provimi final.

## **2.7. Literatura**

Në syllabus studentëve iu ofrohen materialet e nevojshme për lexim, duke përfshirë edhe publikimet aktuale të mësimdhënësve të cilat janë relevante për lëndën. Duhet të bëhet dallimi ndërmjet literaturës primare dhe literaturës shtesë (e rekomanduar për studentët të motivuar për lexim). Rekomandohet që literatura të jetë nga botimet më të fundit, me qëllim të përcjelljes së zhvillimeve të reja shkencore.

## **2.8. Plani i mësimit dhe përmbajta e lëndës (15 javë për semestër)**

Plani i mësimdhënies duhet të jetë i detajuar për çdo javë mësimore veç e veç, duke përfshirë: titujt kryesor të njësive mësimor, aktivitetet për përfshirjen e studentëve. Në orët e planifikuara mësimore duhet t'u japin hapësirë studentëve për aktivitetet mësimore, si: ushtrimet, prezentimet, paraqitja e projekteve, seminareve, etj).

## **2.9. Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes**

Në syllabus duhet të informohen studentët për politikat e mësimdhënësit, disa rregulla të cilat janë të rëndësishme për sjelljen e studentëve dhe krijimin e një ambienti të përshtatshëm për mësimdhënie/nxënie. Këtu përcaktohen disa elemente të cilat kanë të bëjnë vonesat dhe mungesat e studentëve, plagjiaturën, komunikimin, sjelljet e lejuara gjatë diskutimit, etj.



### 3. RISHIKIMI I SYLLABUSIT

Syllabuset në Universitet rishikohen për t'u përshtatur me praktikat më të mira të mësimdhënies/nxënies, të jenë aktuale duke ndjekur trendin e ndryshimeve të fundit shkencore, teknologjike, institucioneve udhëheqëse dhe palëve të interesit.

Gjatë rishikimit sigurohuni që vlerësimi i syllabusit të jetë i përshtatshëm dhe efektiv, të përmirësojë qartësinë e Syllabusit për mësimdhënësin dhe studentët për t'i arritur pritshmëritë.

Rishikimi përfshinë ekzaminimin e syllabusëve aktuale, me qëllim të plotësimit apo ndryshimit aty ku është e nevojshme. Rishikimi i syllabuseve duhet të mbështetet në kornizat e këtij Udhëzuesi.

Për rishikimin e Syllabusit, duhet të ndiqet procedura e cila parashihet me këtë udhëzues.

#### 3.1. Procedura e rishikimit

**Hapi 1:** Rishikimi i Syllabusit në Universitet, bëhet nga mësimdhënësi i lëndës, në rast të plotësimit dhe përmirësimit<sup>3</sup>. Së paku një muaj para fillimit të çdo semestri mësimdhënësi inicion rishikimit e syllabusit, ndërsa miratimi përfundimtar bëhet para fillimit të semestrit.

**Hapi 2:** Gjatë rishikimit të syllabusit mësimdhënësi duhet të merren parasysh rezultatet e vlerësimit të lëndës nga studentët dhe nga palët e tjera të interesit.

**Hapi 3:** Pas analizës së rezultateve të vlerësimit dhe rekomandimeve, mësimdhënësi realizon përmirësimet e nevojshme të syllabusit.

**Hapi 4:** Më pas mësimdhënësi draftin e syllabusit e dërgon për shqyrtim të përgjegjësit e programit. Bartësit e programit e bëjnë shqyrtimin e syllabuseve dhe përputhshmërinë e tyre me programin e studimeve. Përgjegjësit e programit e miratojnë dhe e procedojnë në Këshillin e fakultetit, syllabusin e rishikuar. Në rast, rishikimet e propozuara nga mësimdhënësi janë në kundërshtim me përmbajtjen e programit, përgjegjësit e programit e kthejnë syllabusin te mësimdhënësi i lëndës me arsyetim.

**Hapi 5:** Këshilli i Fakultetit e shqyrton dhe e miraton përfundimisht syllabusin e rishikuar.

---

<sup>3</sup> Gjatë rishikimit të syllabusit, plotësimi dhe ndryshimi mund të bëhet deri në lartësinë të përcaktuara me Manualin për Akreditim, nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA).

**Hapi 6:** Pas miratimit nga Këshilli i Fakultetit, syllabusi i rishikuar fillon të zbatohet.

**Figura 1.** Procesi i rishikimit/ndryshimit të Syllabusit





## Shtojca 1. SHABLLONI i SYLABUSIT

### SYLLABUS I LËNDËS “XXXXX”

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>			
<b>Njësia akademike:</b>			
<b>Titulli i lëndës:</b>			
<b>Programi:</b>			
<b>Niveli:</b>			
<b>Statusi lëndës:</b>			
<b>Viti i studimeve:</b>			
<b>Numri i orëve në javë:</b>			
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>			
<b>Koha / lokacioni:</b>			
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>			
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>			
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>			
<b>Qëllimi i lëndës:</b>			
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>			
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata			
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në terren			
Kollokfiume, seminare			



Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)			
Projektet, prezantimet ,etj			
<b>Totali</b>			<b>150 orë (6 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>			
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>			
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura primare:</b>			
<b>Literatura shtesë:</b>			

<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>
<i>Java e parë:</i>		
<i>Java e dytë:</i>		
<i>Java e tretë:</i>		
<i>Java e katërt:</i>		
<i>Java e pestë:</i>		
<i>Java e gjashtë:</i>		
<i>Java e shtatë:</i>		
<i>Java e tetë:</i>		
<i>Java e nëntë:</i>		
<i>Java e dhjetë:</i>		
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>		
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>		
<i>Java e trembëdhjetë:</i>		
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>		
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>		
<b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>		